



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 265/ 8 prot.

Datë 07.04.2025

V E N D I M
Nr. 447/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.04.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Malvin” SHPK në procedurën objekt shqyrtimi.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Malvin” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-30047-11-19-2024, me objekt: “*Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra dhe ujore*”, me fond limit 106,247,112 (Njëqind e gjashtë milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë pa tvsh ose 1,082,276.7 (një milion e tetëdhjetë e dymijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) Euro. Kursi i këmbimit 98.17 Lekë/Euro, kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 18.11.2024 është 98.17 Lekë/Euro, zhvilluar më datë 20.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Ankimues: Operatori ekonomik “Malvin” SHPK, me NIPT J76403034Q, me adresë Rruga “Jorgji Karamitri”, Shkodër.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër.
Adresa: Rruga “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomikë ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.11.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedura e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-30047-11-19-2024, me objekt: “*Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra dhe ujore*”, me fond limit 106,247,112 (njëqind e gjashtë milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë pa tvsh ose 1,082,276.7 (një milion e tetëdhjetë e dymijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) Euro. Kursi i këmbimit 98.17 Lekë/Euro, kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 18.11.2024 është 98.17 Lekë/Euro, zhvilluar më datë 20.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 20.12.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 14.01.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Malvin” SHPK	95,493,930	lekë skualifikuar
2. BOE “Axis Group” SHPK & “Gjelbrimi 2000” SHPK	75,858,000	lekë skualifikuar
3. “Albgarden” SHPK	100,867,170	lekë kualifikuar

II.4. Në datën 14.01.2025, i operatori ekonomik “Malvin” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Arsyet e refuzimit të ofertës së operatorit ekonomik “Malvin” SHPK:

1. Mangësitë në përmbushjen e kriterëve ekonomike dhe financiare (Kriteri 2.2.2): Subjekti “Malvin” ka dorëzuar bilancet financiare të vitit 2021, 2022 dhe 2023 të konfirmuara nga Administrata Tatimore dhe të shoqëruara me Akt-Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të licensuar, siç kërkohet nga VKM 285/2021 dhe DST, por duke mos arritur plotësimin e këtij kriteri i vetëm ka dorëzuar një deklaratë mbështetje nga shoqëria “Ndërtuesi 2014”, e cila ka dorëzuar vetëdeklarimin dhe vërtetimin për xhiron e tre viteve të fundit, por pa bilancet e kërkuara dhe aktin e ekspertizës. Kjo është një shkelje e kërkesave të tenderit për dokumentacionin financiar për subjektet ofertuese, duke rezultuar në mosplotësimin e kërkesës financiare.

2. Mungesa e certifikatës për personelin e kualifikuar (Kriteri 2.3.6): Subjekti “Malvin” nuk plotëson kërkesën për të disponuar një punonjës me certifikatë “Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë”. Ata kanë paraqitur një certifikatë për një punonjës, z. Skender Halilaj., të pajisur me certifikatë me Nr. AQS/T/S134112024 të leshuar nga shoqëria “AQScert” me NUIS L31511026K. Nga verifikimit i kryer në faqen zyrtare ëë.qkb.gov.al në seksionin “Kërko për Subjekt”, “Shiko licensat aktive”, Shoqëria “AQScert” me NUIS L31511026K rezulton se nuk është e licensuar për ofrimin e formimit profesional, sipas ligjit nr. 15/2017, dhe nuk ka asnjë licencë aktive në regjistrin kombëtar të licencave. Kjo do të thotë që certifikata e leshuar nga një subjektet e palicensuar nuk mund të merret parasysh, dhe kërkesa për këtë certifikatë nuk është përmbushur. Kete qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin Nr. 441/2020 dhe Nr. 745/2022 në lidhje me deshmite të leshuara nga subjektet e palicencuara.

3. Mungesa e certifikatës për personelin e kualifikuar (Kriteri 2.3.7): Operatori ekonomik “Malvin” sh.p.k. me NUIS J76403034Q, nuk plotëson kërkesën e pikes 2.3.7 të “Kapaciteti Teknik” ku kërkohet paraqitja e diplomes së shkolles, deshmi nga organe/institute të

akredituara qe te vertetoje kualifikimin profesional te punonjesve, sipas ligjit Nr. 15/2027 “Per arsimin dhe formimin Profesional ne Republiken e Shqiperise”. Per kete kerkohej plotesimi i formularit sipas shtojces 10 te DT-se si dhe me plotesimin e deklarates sipas Tabeles 1. Operatori “Malvin” sh.p.k. me deklarate “Lista e Punonjesve Specialiste te Shoqerise Malvin” ka deklaruar punonjesit me iniciale A.H , A.H, S. D, N.H, A.A, Sh.K, A.H, me profesion “Punetor Kopshtarie”ku jane te pajisur me diplome me certificate te leshuar nga shoqeria “AQScert”me NUIS L31511026K. Nga verifikimit i kryer ne faqen zyrtare ëë.qkb.gov.al ne seksionin “Kerko per Subjekt”, “Shiko licensat aktive”, Shoqeria “AQScert” me NUIS L31511026K rezulton se nuk është e licencuar për ofrimin e formimit profesional, sipas ligjit nr. 15/2017, dhe nuk ka asnjë licencë aktive në regjistrin kombëtar të licencave. Kete qendrim ka mbajtur edhe KPP ne vendimin Nr. 441/2020 dhe Nr. 745/2022 ne lidhje me deshmitë e leshuara nga subjektet e palicencuara.

4. Mbi përmbushjen e kërkesave të tenderit për shkak të kontratës së njëjtë (Pika e fundit): Subjekti “Malvin” aktualisht po realizon një kontratë të njëjtë për “Shërbimin e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta dhe varrezave në qytetin e Lezhës”, si pjesë e një bashkimi operatorësh me shoqërinë “Floral”. Kjo ka shkaktuar dyshime lidhur me vërtetësinë e vetëdeklarimeve, pasi punonjësit dhe mjetet e deklaruara për këtë kontratë mund të mos mjaftojnë për realizimin e dy kontratave me objekt të njëjtë. Kjo ka ngritur shqetësime lidhur me mundësinë që të dy kontratat e njëjta të përmbushen me të njëjtin personel dhe mjete, gjë që mund të vërë në dyshim kapacitetet e operatorit për të përmbushur kërkesat e tenderit të ri. Për më tepër, në vetëdeklarime, përfaqësuesi i shoqërisë, inxhinieri i pyjeve, drejtuesi teknik dhe përgjegjësi për sigurinë në punë janë përfaqësuar nga i njëjti person, gjë që rrit dyshimet për kapacitetet e vërteta të operatorit për të menaxhuar dy kontrata të ngjashme në të njëjtën kohë. Ne baze te ligjit 162/2020 “Per prokurimin publik”, Neni 92, pika 3, - “Autoriteti kontraktor do te konsideroje nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit”. KVO vendos se per arsyet e mesiperme ky subjekt “Skualifikohet”.

II.5. Në datën 22.01.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 28.01.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2025/5011, dhe nr. 265/2025 prot, datë 28.01.2025 e operatorit ekonomik “Malvin” SHPK nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij në këtë procedurë prokurimi si dhe kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Albgarden” SHPK me argumentat si më poshtë vijon:

Se pari, sqarojme se kompania imalvinë sh.p.k. Ne perputhje me nenin 84 te ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” eshte mbeshtetur tek kapacitet e subjekteve te tjera,

konkretisht tek kapaciteti ekonomik (xhiro vjetore) e kompanise "Ndertuesi 2014" sh.p.k. Ne perputhje me paragrafin 1 te kesaj dispozite, ligji e parashikon dhe e lejon tekstualisht mbeshtetjen ne kapacitetet ekonomike te nje subjekti tjetër. Gjithashtu Autoriteti Kontraktor ne DST e publikuara, pika 2.16 mbeshtetja ne kapacitetet e subjekteve te tjera, nuk e ka kufizuar mbeshtetjen ne kapacitetet e subjekteve te tjera duke i dhene mundesine ofertuesve te mbeshteten ne kapacitetet e subjekteve te tjera pa patur kufizime ne kete pike. Ne lidhje me pretendimin se kompania ne te cilen jemi mbeshtetur nuk ka dorezuar bilancet e tre viteve te fundit, sqarojme se shoqeria "Ndertuesi 2014" sh.p.k., eshte subjekt mbeshtetes vetem per permbushjen e kriterit te xhiros mesatare dhe jo si anetar u bashkimit te operaoreve sic mund ta keqinterpretoje KVO pasi nuk gjejme arsye se perse eshte cituar nga KVO paraqitja e bilanceve nga shoqeria "Ndertuesi 2014" sh.p.k., dhe ne cfare dispozite ligjore apo pike te DST jane mbeshtetur per te bere kete percaktim. Sic cituam me larte, ne jemi mbeshtetur tek subjekti tjetër per kriterin "xhiro vjetore", per kete shkak, referuar nenit 84/3 te ligjit 162 date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" kemi dorezuar ne SPE dhe dokumentacionin perkates te kompanise ne te cilen jemi mbeshtetur. Konkretisht per kompanine "Ndertuesi 2014" kemi ngarkuar ne SPE:

1. Deklaraten me shkrim te ketij subjekti qe angazhohet per mbeshtetur kompanine "Malvin" ne lidhje me kete procedure prokurimi per xhiron vjetore te viteve 2021-2022-2023.
2. Formularin permbledhes te vetdeklarimit ne te cilin percaktohen qartesisht modalitetet e mbeshtetjes.
3. Vertetimin e xhiros vjetore te kompanise "Ndertuesi 2014", i gjeneruar nga portali e-albania i cilin mban edhe nenshkrimin elektronik.

Pretendimi i bilanceve dhe eksperiztes perkatese nuk ka te beje fare me arsyen e mbeshtetjes, por eshte perdorur thjeshte si tendence dhe justifikim nga KVO ne kundërshtim te hapur me parashikimet ligjore. Madje edhe ne momentin qe perdoret si arsye skualifikimi nuk ka ndodnje reference ligjore se ku bazohet KVO per te bere skualifikim, por thjeshte ben nje shpjegim narrativ te aryses duke ju referuar padrejtesisht nje pike tjetër kualifikimi, konkretisht pikes 2.2.2. Te kriterëve te vecanta te kualifikimit (bilanceve dhe eksperzites kontabel), nderkohe ne referim te rrethanave te faktit dhe dokumentave te ngarkuar ne SPE, mbeshtetja eshte bere per piken 2.2.1 te kriterëve te vecanta te kualifikimit.

Sa me siper shikohet qartesisht se aryeja e skualifikimit nuk qendron.

Se dyti, ne lidhje me pretendimin se Z. Skender Halilaj, të pajisur me certifikatë me Nr. AQS/T/S134112024 të leshuar nga shoqëria AQScert me NUIS L31511026K. Nga verifikimit i kryer në faqen zyrtare ëëë.qkb.gov.al ne seksionin "kërko për subjekt", "shiko licensat aktive", shoqeria AQScert me NUIS L31511026K rezulton se nuk është e licencuar për ofrimin e formimit profesional, sipas ligjit nr. 15/2017, dhe nuk ka asnjë licencë aktive në regjistrin kombëtar të licencave. Kjo do të thotë që certifikata e lëshuar nga një subjektet e palicensuar nuk mund të merret parasysh, dhe kërkesa për këtë certifikatë nuk është përmbushur dhe se kjo bie ndesh me piken 2.3.6. te kriterëve te vecanta te sualifikimit, sqarojme si vijon dy element per kete pike skualifikimi.

1. Skualifikimi per kete arsye eshte jo ne perputhje me ligjin procedural. KVO ne kete faze nuk mund te beje skualifikimin e operatorit ekonomik, pasi ky kriter plotesohet me ane te

Formularin Permbledhes te Vetdeklarimit. Per plotesimin e ketij kriteri ne kemi paraqitur formularin permbledhes te vetdeklarimit nga ku kemi specifikuar se personi i cili do te jete Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune, Z.Skender Halilaj, njekohesisht edhe Inxhinier Pyjesh dhe plotesisht i kualifikuar per realizimin e ketij kriteri qe ka vendosur AK. Plotesimi i kriterit eshte ne perputhje te plote me nenin 26/h te VKM nr.285 date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" po ashtu edhe me nenin 82 te ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 "Per prokurimin publik". Nga ana tjeter ky parashkim ligjor gjen mbeshtetje dhe implementim ne Vendimin nr. 2969/15 te dates 06.03.2024 te KPP. Sipas ketij vendimi eshte sqaruar plotesisht detyrimi i AK per te marre si prove te plote dhe si kusht kualifikimi vetem deklarimet e bera nga subjekti pjesemarres ne nje procedure prokurimi nepermjet formularit permbledhes te vetdeklarimit. Po ashtu edhe ne DST per kete procedure prokurimi eshte percaktuar qartesisht procedura qe duhejt te ndiqte KVO dhe AK ne lidhje me plotesimin apo jo te ketij kriteri, konkretisht pika 2.3.6 i kriterëve te vecanta per kualifikim percakton se: 2.3.6 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si: 1 (një) punonjës me certifikatë përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt të fundit (Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili nga operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë sipas zerave te sherbimeve qe marrin persiper ne realizim e kontrates sipas aktmarreveshjes). Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor. Sic percaktohet me siper KVO ka gabuar ne skualifikim e operatorit "Malvin" duke keq interpretuar ligjin dhe DST ne menyre te padrejte pasi ne DST shprehet qarte se ky kriter plotesohet me plotesimin e formularit te vetdeklarimit sipas shtojces 10 te DST.

2. Sqarojme se per kete pike skualifikimi eshte zbatuar gabim edhe ligji material, konkretisht edhe ajo qe eshte shkruar ne arsyen e skualifikimit nuk qendron. Konkretisht kompania AQScert eshte e akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit, fakt ky lehtesisht i verifikueshem edhe on-line ne adresen <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara>. Ky ëeb-side provon qartesisht se kjo kompani eshte e licencuar dhe mban licence nr.CS 008 perkatesisht per fushen e certifikimit.

Sa me siper shikohet qartesisht se aryeja e sikualifikimit nuk qendron.

Se treti, ne lidhje me pretendimin se operatori ekonomik "Malvin" sh.p.k. Me NUIS J76403034Q, nuk ploteson kerkesen e pikes 2.3.7 te kapaciteti teknik ku kerkohet paraqitja e diplomes se shkolles, deshmi nga organe/institute te akredituara qe te vertetoje kualifikimin profesional te punonjesve, sipas ligjit Nr. 15/2027 "Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise". Per kete kerkohej plotesimi i formularit sipas shtojces 10 te DT-se si dhe me plotesimin e deklarates sipas Tabeles 1. Operatori "Malvin" sh.p.k me deklarate "lista e punonjesve specialiste te shoqerise malvin" ka deklaruar punonjesit me iniciale A.H, A.H, S. D, N.H, A.A, Sh.K, A.H, me profesion Punetor Kopshtarie ku jane të pajisur me diplome

me certifikate të leshuar nga shoqëria AQScert me NUIS L31511026K. Nga verifikimit i kryer në faqen zyrtare ëëë.qkb.gov.al ne seksionin “kërko për subjekt”, “shiko licensat aktive”, Shoqëria AQScert me NUIS L31511026K rezulton se nuk është e licencuar për ofrimin e formimit profesional, sipas ligjit nr. 15/2017, dhe nuk ka asnjë licencë aktive në regjistrin kombëtar të licencave, sqarojme se:

1. Skualifikimi për këte arsye është jo ne përputhje me ligjin procedural. KVO ne këte fazë nuk mund të bëjë skualifikimin e operatorit ekonomik, pasi ky kriter plotësohet me anë të Formularit Permbledhës të Vetdeklarimit. Për plotësimin e këtij kriteri ne kemi paraqitur formularin permbledhës të vetdeklarimit nga ku kemi specifikuar se personat të cilët do të jete punetore kopshtarie, .A.H, A.H, S. D, N.H, A.A, Sh.K, A.H janë persona pershtatshem, të certifikuar dhe të trajnuar posacerisht dhe kanë eksperience disa vjecare ne realizimin e këtij sherbimi plotësimi i kriterit është ne përputhje të plotë me nenin 26/h të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” po ashtu edhe me nenin 82 të ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Nga ana tjetër ky parashkim ligjor gjen mbështetje dhe implementim ne Vendimin nr. 2969/15 të dates 06.03.2024 të KPP. Sipas këtij vendimi është sqaruar plotësisht detyrimi i AK për të marrë si provë të plotë dhe si kusht kualifikimi vetëm deklaratimet e bera nga subjekti pjesëmarrës ne një procedure prokurimi nepermjet formularit permbledhës të vetdeklarimit. Po ashtu edhe ne DST për këte procedure prokurimi është percaktuar qartësisht procedura që duhejt të ndiqte KVO dhe AK ne lidhje me plotësimin apo jo të këtij kriteri, konkretisht pika 2.3.7 i kriterëve të vecanta për kualifikim percakton se: 2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, si më poshtë:

6 (gjashtë) punonjës të trajnuar për punime në kopshtari

1 (një) shofer

1 (një) manovrator

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: - Kontratën individuale të punës të vlefshme; - Diplomën e shkolles/deshmi nga organe/institute të akredituar që të vërtetojë kualifikimin profesional të punonjesve të mësipërm sipas ligjit Nr. 15/2017 i për arsimin dhe formimin profesional ne republikën shqipërisë. - Listëpagesat për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë ne lidhje me stafin që disponon sa më sipër sipas formatit të mëposhtëm: Tab 1 Emer Mbiemer i punonjesit dhe nr identifikimi Profesionit Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes Nr NIPT (ne rast se leshuesi është institucion privat). Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT si dhe me plotësimin e formatit të deklaratës sipas Tab 1. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Sic percaktohet me sipër KVO ka gabuar ne skualifikim e operatorit “Malvin” duke keq interpretuar ligjin dhe DST ne menyre të padrejte pasi ne DST shprehet qarte se ky kriter plotësohet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Sqarojme se

per kete pike skualifikimi eshte zbatuar gabim edhe ligji material, konkretisht edhe ajo qe eshte shkruar ne arsyen e skualifikimit nuk qendron. Konkretisht kompania aqscert eshte e akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit, fakt ky lehtesisht i verifikueshem edhe on-line ne adresen <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara>. Ky eeb-side provon qartesisht se kjo kompani eshte e licencuar dhe mban licence nr.CS 008 perkatesisht per fushen e certifikimit.

Sa me siper shikohet qartesisht se aryeja e sikualifikimit nuk qendron.

Se katerti, ne lidhje me pretendimin se mbi permbushjen e kerkesave te tenderit per shkak te kontrates se njejte (Pika e fundit) nga KVO eshte cituar: Subjekti Malvin aktualisht po realizon nje kontrate te njejte per sherbimin e mirembajtjes se sipërfaqeve te gjelbertha dhe varrezave ne qytetin e lezhës, si pjesë e një bashkimi operatorësh me shoqërinë “Floral”. Kjo ka shkaktuar dyshime lidhur me vërtetësinë e vetëdeklarimeve, pasi punonjësit dhe mjetet e deklaruar për këtë kontratë mund të mos mjaftojnë për realizimin e dy kontratave me objekt të njëjtë. Kjo ka ngritur shqetësime lidhur me mundësinë që të dy kontratat e njëjta të përmbushen me të njëjtin personel dhe mjete, gjë që mund të vërë në dyshim kapacitetet e operatorit për të përmbushur kërkesat e tenderit të ri.

Për më tepër, në vetëdeklarime, përfaqësuesi i shoqërisë, inxhinieri i pyjeve, drejtuesi teknik dhe përgjegjësi për sigurinë në punë janë përfaqësuar nga i njëjti person, gjë që rrit dyshimet për kapacitetet e vërteta të operatorit për të menaxhuar dy kontrata të ngjashme në të njëjtën kohë. Ne baze te ligjit 162/2020 i per prokurimin publikë, Neni 92, pika 3, - “Autoriteti kontraktor do te konsideroje nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit”, KVO vendos se per arsyet e mesiperme ky subjekt skualifikohet.

Sqarojme se: Ky pretendim nuk qendron dhe eshte vetem hamendesim nga ana KVO dhe AK. Ky pretendim nuk qendron dhe eshte vetem hamendesim nga ana KVO dhe AK. Ne DST e publikuara dhe kriteret e percaktuara per kualifikim ne asnje vend nuk eshte e shprehur qe drejtuesi teknik, punonjesit apo makinerite nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. KVO duhet te vleresojë nje oferte nese eshte e vlefshme apo jo vetem mbi bazen e kriterëve te percaktuara nga vete Autoriteti Kontraktor ne DST dhe jo te dale jashte kesaj kornize duke vleresuar mbi kriteret qe nuk jane te percaktuara ne DST. KVO nuk mund te shprehet se angazhimi i shoqerise Malvin sh.p.k ne nje kontrate tjeter ka ngritur dyshime apo ka shkaktuar shqetesime pasi dyshimet ngrihen nga organe te tjera te zbatimit te ligjit ndersa KVO duhet te shqetesohet vetem per vleresimin e sakte dhe zbatimin korrekt te ligjit dhe jo te marre tagra te tjere qe ligji ja ka dhene institucioneve te tjera. Pamvaresisht sa u citua me lart nuk eshte i vertete fakti se Ing.Skender Halilaj apo punetore te tjere te propozuar nga ana jone per tu angazhuar ne kete kontrate jane te angazhuara ne kontrata te tjera. Perfundimi i nxjerre nga AK dhe KVO nuk eshte i mbeshtetur ne asnje lloj verifikimi zyrtar, kerkese per sqarim etj por thjeshte kane perdorur biseda informale qe mund te jene thene edhe nga persona qe kane pasur tendence dhe interes per skualifikimin e operatorit Malvin dhe favorizimin e operatorit Alb Garden. Vleresimi eshte tmerresisht jo profesional, eshte plotesisht amator dhe mbi te gjitha i pavartetuar dhe ne kundërshtim me parashikimet ligjore. Nje gje e tille eshte bere vetem per te favorizuar operatoret e tjere ne menyre tendencioze.

Sa më sipër shikohet qartësisht se aryeja e skualifikimit nuk qendron. Mbi qendrimin tone për skualifikimin e operatorit “Alb Garden”

Se pari, kemi bindjen e plotë se kompania Alb Garden nuk plotëson kriterin e shërbimeve të ngjashme. Konkretisht nga verifikimi në portalin <https://openprocurement.al/sq/tender/list/corporate>, rezulton se kjo kompani në 5 vitet e fundit të ushtrimit të aktivitetit nuk ka realizuar ndonjë kontratë shërbimi mirembajtje sipërfaqe të gjelberta në vlerën dhe llojin që përcaktohet në DST por vetëm kontrata furnizimit të mallit. Konkretisht në DST është përcaktuar se: 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 21,249,422 (njëzet e një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e njëzet e dy) Lëke. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a. Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës. b. Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Sipas indicieve dhe verifikimeve të bëra nga ana jone kjo kompani nuk e plotëson këto kriter dhe është kualifikuar në mënyrë të padrejte.

Se dyti, duke qenë se kompania ALB Garden merret kryesisht vetëm me shitje fidanesh, nuk ka asnjë mjetet e kerkuara në DST pasi janë specifike për mirembajtjen e sipërfaqeve të gjelberta.

Se treti, po ashtu nisur nga fakti se kjo kompani sic e citova merret kryesisht me shitje fidanesh dekorativ, në vlerësimin tone nuk ka asnjë stafit dhe personelin tjetër të nevojshëm për realizimin e këtij shërbimi.

Se katërti, ajo që e bën me të dyshimte vendimin e AK dhe KVO është fakti se na rezulton se përpjekjet për verifikimin e angazhimit të kompanive, të stafit, mjeteve apo personelit në kontrata të tjera është bërë në mënyrë të njëanshme vetëm për subjektin imalvinë. Në fakt AK nuk jep asnjë të dhënë se si është bërë verifikimi i kompanisë Malvin por nga ana tjetër nuk rezulton të jetë bërë ndonjë verifikim i kompanisë Alb Garden. Natyrshëm lind pyetja si ka mundësi që KVO dhe AK nuk binden me seriozitetin e kompanisë Malvin, nderkohe që binden me kompaninë Alb Garden e cila në fakt sipas njoftimit publik të bërë në buletin nr.85 datë 13 tetor 2023 është përjashtuar nga përfitimi i marrjes së kontratave publike për periudhën 10.10.2023 deri më 10.10.2024. Të gjitha këto elemente bëjnë shumë të dyshimte kualifikimin e Alb Garden dhe në tërësi vendimarrjen e AK dhe KVO.

Sa më sipër kërkojmë nga ana e KPP të rregullohen këto shkelje flagrante ligjore dhe në përfundim të hetimit administrativ të vendos:

1. Pranimin e Ankeses se Shoqerise "Malvin" Sh.P.K.

2. Rivleresimin e Procedures se Prokurimit duke Kualifikuar dhe Shpallur Fitues Kompanine "Malvin" dhe duke Skualifikuar Operatorin Tjeter "Alb Garden".

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 265/1 prot., datë 29.01.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik "Malvin" SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 265/2025 prot, datë 28.01.2025, si dhe kriteret për të cilat ankimuesi pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik "AlbGarden" SHPK.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 19991/12 prot., datë 03.02.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 265/2 prot., datë 04.02.2025 si dhe shkresës nr. 19991/13 prot, datë 04.02.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 265/3 prot, datë 07.02.2025 me objekt "Vendim i ndërmjetëm për verifikim pranë organeve të tjera mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Malvin" (ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike dhe shërbimit postar), nëpërmjetë të cilit autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik se do të nderpresë afatin 5 ditor për tu shprehur në lidhje me ankesën për shkak të verifikimeve pranë organeve të tjera.

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr. 19991/15 prot., datë 28.02.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 265/4 prot., datë 04.03.2025 me objekt "Kthim Përgjigje", (ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike), është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës me argumentat si vijon:

Vleresim i komisionit.

Pretendimet tuaja sa më sipër nuk qendrojnë pasi:

Në nenin 84, "Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera", pikat 1 dhe 5 te Ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar percaktohet se: "Operatori ekonomik, me qellim plotësimin e kerkesave të percaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike financiare, aftësi teknike ose profesionale te subjekteve të tjera, pavaresisht natyrës juridike te lidhjeve që ai ka me ta. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër ne lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë qe operatori ekonomik dhe subjekti te ndermarrin pergjegjësi solidare per zbatimin e marrëveshjes".

Ne vijim, në nenin 90 "Mbështetja ne kapacitetet e subjekteve të tjera", pika 2, të VKM nr. 285 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar percaktohet se:

“Kur një operator ekonomik deshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;*
- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.*
- t'i provoje autoritetit/entit kontraktor se per subjektin, aftësinë, e te cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojne shkaqet per skualifikimin ose perjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.*
- Në cdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet te provojë se plotëson të paktën 50% të kerkesave të percaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”.*

Referuar kërkesave të percaktuara në dst, Shtojca 9, rezulton se në Kriteret e Veçanta te Kualifikimit, pika 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” Autoriteti Kontraktor, me qellim plotesimin e këtij kriteri ka kerkuar 3 kriteret te veçanta dhe konkretisht: 2) kriterin për xhiron; 2) kriterin për kopje te bilanceve të certifikuara shoqëruar me Akt ekspertizën e ekspertit kontabël; dhe 3) kriterin për pagesën e taksave dhe tarifave vendore.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Malvin” sh.p.k., perfshire edhe dokumentacionin e subjektit ku është mbështetur shoqëria “Ndërtues 2014” sh.p.k, ne raport me kerkesat e percaktuara ne dst, rezulton se ky operator ekonomik ka paraqitur vetëm 1 nga 3 kerkesat e kapacitetit ekonomik të kërkuara në pikën 2.2.

Bazua, ne percaktimet ligjore te nenit 84 te Ligjit te Prokurimit, e veçanerisht në dispozitat e parashikuara ne nenin 90 pika 2, të VKM 285 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku normohet se: “subjektet qe ofrojne mbeshtetjen duhet te provojne se plotesojne te paktën 50% te kerkesave te percaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”, si dhe duke marre ne analize dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “Malvin” SHPK, rezulton se kerkesa e parashikuar në nenin 90, pika 2 te VKM 285 nuk është permbushur. Per pasojë vleresimi i KVO është i sakte per kete pike.

Vleresim i Komisionit.

Sa i takon pretendimeve Tuaja, ne piken 2 dhe 3 sa sipër, nuk qendrojne pasi:

Ne nenin 87 “Kriteret per shpalljen e ofertes fituese”, pika 4 te Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” percaktohet se: “Kriteret per shpalljen e kontrates fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor nje liri te pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantone mundësinë e konkurrences efektive dhe shoqrohen nga specifikime, te cilat lejojne qe informacionet e dhena nga ofertuesit te verifikohen per te vleresuar nese ofertat permbushin kriteret per shpalljen e kontrates fituese. Ne rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojne saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit”. Referuar percaktimeve ligjore te sipercituara, rezulton e qarte se ligjvenesi e ka qartesuar momentin procedural se kur behen verifikime te dokumentacionit te paraqitur nga konkuruesit ne nje procedure prokurimi dhe konkretisht ky proces kryhet ne momentin e vlerësimit te ofertave. Pikerisht parashikimi ligjor “saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit” i percaktuar ne nenin 87,

pika 4 legjitimon Autoritetin Kontraktor që ne rast se ka dyshime, ben verifikimin e saktësisë së dokumentacionit të paraqitur nga “Ofertuesit”. Qartazi norma ligjore e sipercituar, legjitimon Autoritetin Kontraktor të kryejë në këto faze të procedurës, verifikimet e nevojshme dhe në rastin konkret rezulton se AK kishte arsye ligjore për verifikim dokumentacioni.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik për shkelje të ligjit procedural nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes për shkelje të ligjit material rezulton se: Komisioni i Vlerësimit të ofertave të kësaj procedure prokurimi, pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “Malvin” sh.p.k., ka konstatuar se subjekti që ky operator ekonomik ka certifikuar punonjësit është Shoqëria AQScert me NUIS L31511026K. Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare <http://ëëë.qkb.gov.al> për shoqërinë AQScert me NUIS L31511026K rezulton se ajo nuk është e licencuar për ofrimin e formimit profesional, sipas ligjit nr. 15/2017, dhe nuk ka anje licence aktive në regjistrin kombëtar të licencave. Bazuar në këto verifikime KVO ka kryer vlerësimin përkatës. Në vijim, pasi është njohur me pretendimet e operatorit ekonomik “Malvin” sh.p.k., Autoriteti Kontraktor ka vepruar si vijon: Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, nëni 100 “Afatet e shqyrtimit të ankesave nga autoriteti/enti kontraktor”, pika 3 citon se: “Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës, autoriteti /enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 2 të këtij nenti, nderpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kerkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kerkuar, afati nuk duhet të tejkalojë 30 (tridhjetë) ditë”. Në kuptim të kësaj dispozite, me anë të shkresës nr. 2184 prot, datë 03.02.2025 “Kerkese për informacion” AK i është drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, nëpërmjetë të ciles është kerkuar nëse “Subjekti AQScert me NUIS L31511026K A është i licencuar nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe a disponon licence për të ofruar kurse trajnimi për formimin profesional në përputhje me ligjin nr.15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”. Nëse po, lutemi të na përcillni dokumentacionin përkatës”. Sipas shkresës të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive nr. 330/1 prot, datë 18.02.2025 “Kthim përgjigje” behet me dije ndër të tjera se: “Në lidhje me informacionin e kerkuar prej jush për subjektin AQScert me NUIS L31511026K nga verifikimet e bëra në regjistrin kombëtar të Licencave të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton se subjekti nuk është i licencuar për formim profesional”. Bazuar në përgjigjen zyrtare të cituar më sipër, rezulton e qartë se subjekti AQScert me NUIS L31511026K nuk është i licencuar për formim profesional. Në këto kushte, operatori ekonomik “Malvin” sh.p.k., nuk plotëson kriterin e kerkuar në DST - Shtojca 9, pika 2.3.7 që të vertetojë kualifikimin profesional të punonjësve sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën Shqipërisë”. Për pasoje vlerësimi i KVO është i saktë për këto pika.

Vlerësim i Komisionit.

Pretendimet e operatorit ekonomik “Malvin” sh.p.k. për këtë pikë qëndrojnë pasi:

Referuar kritereve te kualifikimit, te kerkuara ne Shtojcen 9 te DST, rezulton se nga Autoriteti Kontraktor nuk parashikohet asnje kufizim, ndalesë apo percaktim konkret lidhur me angazhimin e personelit apo mjeteve ne kontrata te tjera publike. Në nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar percaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të ketij neni, vlerëson nje oferte të vlefshme vetëm nëse ajo eshte në perputhje me të gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me percaktimet e nenit 38 të këtij ligji”. Bazuar në sa mësipër, rezulton se oferta e operatorit ekonomik “Malvin” sh.p.k. do të shqyrtohet dhe verifikohet vetem në raport me kriteret e percaktuara paraprakisht ne DST nga Autoriteti Kontraktor, e ne rastin konkret, duke qene se nuk ka një kriter te percaktuar për mos angazhimin e mjeteve dhe personelit në kontrata te tjera, skualifikimi per nje kriter të pa kerkuar nuk qëndron. Per pasoje vlerësimi i KVO eshte i pasakte per këte pikë.

Vlerësim i Komisionit.

Paraprakisht sjellim ne vëmendjen tuaj se ne mënyre që shoqëria “Malvin” sh.p.k. të ngreje pretendime për nje operator ekonomik tjetër konkurues ne këte procedure duhet të provoje se ka interes te ligjshem dhe potencialisht do te jetë fituese në një garë. Ne rastin konkret rezulton se operatori ekonomik “Malvin” sh.p.k., ka paraqitur oferten me të ulët ne këtë procedure prokurimi ne të cilën konstatohet se kane paraqitur oferte 3 operatore ekonomike dhe perkatesisht: 1) Malvin me vlere 95,493,930.00 lekë; 2) Axis Group me vlere 98,816,877.00 lekë dhe 3) Alb Garden me vlere 100,867,170.00 lekë.

Ne këto kushte vlerësojme se interesi i ligjshem i operatorit ekonomik ankimues “Malvin” sh.p.k., do të permbushet vetëm me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga ai në këte procedure prokurimi, dhe asnjë pretendim mbi dy ofertat e operatoreve të tjerë pjesëmarrës ne gare nuk mund të cenoje interesin e ligjshem të OE “Malvin” sh.p.k., ne rast se ai kualifikohet dhe shpallet fitues i kesaj procedure.

Për pasoje shqyrtimi i pretendimeve per operatore të tjere ekonomike, te cilët nuk e cenojne ofertën e paraqitur nga ky operator në rast kualifikimi, nuk do te merret ne konsiderate nga Autoriteti Kontraktor per sa kohe nuk ka interes të ligjshëm. Ne analize te fakteve, në cilesine e zyrtarit të caktuar per shqyrtimin e ankesës, referuar parashtrimeve te mesipërme dhe ne mbështetje të nenit 114, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” pika 3, gërma c, dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar, neni 102, pika 1, germa c.

Vendosa:

1. Te refuzoje kerkesën e operatorit ekonomik “MALVIN” sh.p.k me NUIS nr. J76403034Q, për procedurën e prokurimit publik me objekt: “Mirembajtje e siperfaqeve te gjelbra dhe ujore”, per pikat 1, 2, 3, dhe 5, si dhe te pranojë ankesën per pikën 4.

II.10. Nëpërmjet shkresës me nr. 19991/16 prot., datë 03.03.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 265/5 prot., datë 06.03.2025 me objekt “Informacion”, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacion në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Malvin” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: *“Mbi përmbushjen e kërkesave të tenderit për shkak të kontratës së njëjtë (Pika e fundit): Subjekti “Malvin” aktualisht po realizon një kontratë të njëjtë për “Shërbimin e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta dhe varrezave në qytetin e Lezhës”, si pjesë e një bashkimi operatorësh me shoqërinë “Floral”. Kjo ka shkaktuar dyshime lidhur me vërtetësinë e vetëdeklarimeve, pasi punonjësit dhe mjetet e deklaruara për këtë kontratë mund të mos mjaftojnë për realizimin e dy kontratave me objekt të njëjtë. Kjo ka ngritur shqetësime lidhur me mundësinë që të dy kontratat e njëjta të përmbushen me të njëjtin personel dhe mjete, gjë që mund të vërë në dyshim kapacitetet e operatorit për të përmbushur kërkesat e tenderit të ri. Për më tepër, në vetëdeklarime, përfaqësuesi i shoqërisë, inxhinieri i pyjeve, drejtuesi teknik dhe përgjegjësi për sigurinë në punë janë përfaqësuar nga i njëjti person, gjë që rrit dyshimet për kapacitetet e vërteta të operatorit për të menaxhuar dy kontrata të ngjashme në të njëjtën kohë. Ne baze të ligjit 162/2020 “Per prokurimin publik”, Neni 92, pika 3, - “Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontrates dhe në dokumentet e tenderit”. KVO vendos se për arsyet e mësipërme ky subjekt “Skualifikohet” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Me anë të shkresës Nr. 19991/15 prot., datë 28.02.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 265/4 prot., datë 04.03.2025 me objekt “Kthim Përgjigje”, (ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike), është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës përse i përketë pikës katër të saj me argumentin si vijon: [...] *Pretendimet e operatorit ekonomik “Malvin” sh.p.k. për këtë pikë qendrojnë pasi referuar kritereve të kualifikimit, të kërkuara në Shtojcën 9 të DST, rezultojnë se nga Autoriteti Kontraktor nuk parashikohet asnjë kufizim, ndalesë apo percaktim konkret lidhur me angazhimin e personelit apo mjeteve në kontrata të tjera publike. Në nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar percaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo*

eshte në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me percaktimet e nenit 38 të këtij ligji”. Bazuar në sa mësipër, rezulton se oferta e operatorit ekonomik “Malvin” sh.p.k. do të shqyrtohet dhe verifikohet vetem në raport me kriteret e percaktuara paraprakisht në DST nga Autoriteti Kontraktor, e në rastin konkret, duke qenë se nuk ka një kriter të percaktuar për mos angazhimin e mjeteve dhe personelit në kontrata të tjera, skualifikimi për një kriter të pa kërkuar nuk qëndron. Për pasojë vlerësimi i KVO është i pasakte për këte pikë.

II.1.2. Neni 30, e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115, pika 1 dhe 2, e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të percaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër. Duke qenë, se pretendimi i mësipërm i operatorit ekonomik ankimes “Malvin” SHPK në lidhje me arsyen e skualifikimit se “Subjekti “Malvin” aktualisht po realizon një kontratë të njëjtë për “Shërbimin e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta dhe varrezave në qytetin e Lezhës”, si pjesë e një bashkimi operatorësh me shoqërinë “Floral”. Kjo ka shkaktuar dyshime lidhur me vërtetësinë e vetëdeklarimeve, pasi punonjësit dhe mjetet e deklaruara për këtë kontratë mund të mos mjaftojnë për realizimin e dy kontratave me objekt të njëjtë. Kjo ka ngritur shqetësime lidhur me mundësinë që të dy kontratat e njëjta të përmbushen me të njëjtin personel dhe mjete, gjë që mund të vërë në dyshim kapacitetet e operatorit për të përmbushur kërkesat e tenderit të ri. Për më tepër, në vetëdeklarime, përfaqësuesi i shoqërisë, inxhinieri i pyjeve, drejtuesi

teknik dhe përgjegjësi për sigurinë në punë janë përfaqësuar nga i njëjti person, gjë që rrit dyshimet për kapacitetet e vërteta të operatorit për të menaxhuar dy kontrata të ngjashme në të njëjtën kohë”, rezulton të jetë pranuar nga autoriteti kontraktor, gjithashtu referuar dhe materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik argumente në kuptim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nga subjekte të interesuara. Ndodhur në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të mbyllë çështjen përse i përketë arsyes së skualifikimit të sipërcituar në procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Malvin” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: *“Mangësitë në përmbushjen e kriterëve ekonomike dhe financiare (Kriteri 2.2.2): Subjekti “Malvin” ka dorëzuar bilancet financiare të vitit 2021, 2022 dhe 2023 të konfirmuara nga Administrata Tatimore dhe të shoqëruara me Akt-Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të licensuar, siç kërkohet nga VKM 285/2021 dhe DST, por duke mos arritur plotësimin e këtij kriteri i vetem ka dorëzuar një deklaratë mbështetje nga shoqëria “Ndërtuesi 2014”, e cila ka dorëzuar vetëdeklarimin dhe vërtetimin për xhiron e tre viteve të fundit, por pa bilancet e kërkuara dhe aktin e ekspertizës. Kjo është një shkelje e kërkesave të tenderit për dokumentacionin financiar për subjektet ofertuese, duke rezultuar në mosplotësimin e kërkesës financiare”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2.1 dhe 2.2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021-2022-2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **42,498,844** (dyzet e dy milion e katerqind e nentëdhjetë e tete mijë e teteqind e dyzet e kater)leke.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.2.2. *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2021-2022-2023 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivi.*

III.2.2. Në përmbushje të kriterëve më sipër cituar, operatori ekonomik “Malvin” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

- 1- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Malvin” SHPK. Në Pjesën I: “*Informacion në lidhje me operatorin ekonomik*”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet operatori ekonomik (nëse është e zbatueshme) operatori ekonomik “Malvin” SHPK ka deklaruar në këtë deklaratë subjektin mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet konkretisht operatori ekonomik “Malvin” SHPK do të mbështetet mbi kapacitetin e operatorit ekonomik “Ndërtuesi 2014” SHPK për kapacitetin ekonomiko-financiar pikën 2.2.1 në lidhje me xhiron vjetore për vitet financiare 2021-2022-2023.
- 2- Vërtetim Nr. T12061593 datë 16.12.2024 (Për xhiron e tre viteve të fundit 2021-2022-2023 të operatorit ekonomik “Malvin” SHPK;
- 3- Shkresa nr. 4123/1 prot., datë 06.12.2024 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër me objekt “Kthim përgjigje” dhe përmbajtje: “Në përgjigje të kërkësës suaj, tonës me nr. 4123 prot, datë 06.12.2024, bashkalidhur po ju dërgojmë kopje të njësuara me origjinalin të deklaruar online në sistemin tatimor cats, si mëposhtëshënuar të”, Pasqyrave financiare të vitit 2021, 20 (njëzetë) fletë.
Pasqyrave financiare të vitit 2022, 22 (njëzetë e dy) fletë.
Pasqyrave financiare të vitit 2023, 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë.
- 4- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Ndërtimi 2014” SHPK.
- 5- Deklaratë angazhimi e datës 20.12.2024 e subjektit mbështetës “Ndërtimi 2014” SHPK i cili deklaron se do të mbështesë subjektin “Malvin” SHPK për kapacitetin e xhiros për vitet 2021-2022-2023;
- 6- Vërtetim Nr. T12091289 datë 19.12.2024 (Për xhiron e tre viteve të fundit 2021-2022-2023 të operatorit ekonomik “Ndërtimi 2014” SHPK;

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të

padrejtë operatorë ekonomike të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.4. Në nenin 21, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, thuhet shprehimisht: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

III.2.5. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të

gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.6. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare . 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme”.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

6. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës”.

III.2.7. Neni 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;
- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.
- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.
- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.2.8. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Marrë shkas nga arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Malvin” SHPK, KPP vëren se në rastin konkret, ofertuesi “Malvin” SHPK, ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si subjekt mbështetës për plotësimin e xhiros operatorin ekonomik “Ndërtimi 2014” SHPK. Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri kualifikimi konkretisht për xhiron, operatori ekonomik “Malvin” SHPK ka ngarkuar në sistem **1-** Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Malvin” SHPK. Në Pjesën I: “Informacion në lidhje me operatorin ekonomik”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet operatori ekonomik (nëse është e zbatueshme) operatori ekonomik “Malvin” SHPK ka deklaruar në këtë deklaratë subjektin mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet konkretisht operatori ekonomik “Malvin” SHPK do të mbështetet mbi kapacitetin e operatorit ekonomik “Ndërtuesi 20114” SHPK për kapacitetin ekonomik-financiar pikën 2.2.1 në lidhje me xhiron vjetore për vitet financiare 2021-2022-2023; **2-** Vërtetim Nr. T12061593 datë 16.12.2024 Vërtetim (Për xhiron e tre viteve të fundit 2021-2022-2023 të operatorit ekonomik “Malvin” SHPK; **3-** Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Ndërtimi 2014” SHPK; **4-** Deklaratë angazhimi e datës 20.12.2024 e subjektit mbështetës “Ndërtimi 2014” SHPK i cili deklaron se do të mbështesë subjektin “Malvin” SHPK për kapacitetin e xhiros për vitet 2021-2022-2023; **5-** Vërtetim Nr. T12091289 datë 19.12.2024 Vërtetim (Për xhiron e tre viteve të fundit 2021-2022-2023 të operatorit ekonomik “Ndërtimi 2014” SHPK;

Koncretisht, referuar dokumentacionit të sipërcituar rezulton se operatori ekonomik ankimues “Malvin” SHPK në përmbushje të kriterit kualifikues përsa i përketë kapacitetit të xhiros, ka deklaruar si subjekt mbështetës operatorin ekonomik “Ndërtuesi 2014” SHPK për përmbushjen e kriterit 2.2.1 financiar, për xhiron e tre viteve të fundit, ka deklaruar Vërtetim Nr. T12091289 datë 19.12.2024, për xhiron e tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) por vlera e xhiros së deklaruar nga ky operator ekonomik është në masën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor për kriterin financiar të xhiros së tre viteve të fundit, referuar pikës 2 të nenit 90 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. KPP konstaton se, vlera e parashikuar e xhiros për kontratën që prokurohet nga autoriteti kontraktor, është 42,498,844 lekë. Mbështetur në vërtetimet e xhirove të 3 viteve të fundit për subjektin “Malvin” 17,288,733 lekë > 42,498,844

(xhiro për vitin 2021); 34,218,988 lekë > 42,498,844 lekë (xhiro për vitin 2022); 34,915,949 lekë > 42,498,844 lekë (xhiro për vitin 2023); Nga sa më sipër përlllogaritur, KPP konstaton se, asnjëra vlerë e secilit vit (2021,2022,2023) të deklaruar nga operatori ekonomik “Malvin” SHPK nuk përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht 42,498,844. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik “Malvin” SHPK ka deklaruar subjekt mbështetës operatorin ekonomik “Ndërtimi 2014” SHPK, në përmbushje të kriterit 2.2.1 Xhiron e tre viteve të fundit. Subjekti Mbështetës “Ndërtimi 2014” SHPK ka dorëzuar vërtetimi xhiro e tre viteve të fundit me Nr. T12091289 datë 19.12.2024, 498,947,556 lekë > 42,498,844 (xhiro për vitin 2021), 469,489,581 lekë > 42,498,844 (xhiro për vitin 2022), 472,069,284 lekë > 42,498,844 (xhiro për vitin 2023), Formular Përmbledhës së vetdeklarimit, si dhe Deklaratën e Angazhimit. Në këtë kuadër, referuar të dhënave të dokumentacionit të operatorit ekonomik “Malvin” SHPK si edhe kërkesave për kualifikim, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.2.1, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Malvin” SHPK në këtë procedurë prokurimi është në përputhje me kriteret për kualifikim, pasi e arrin vlerën e secilit vit (2021, 2022, 2023) të deklaruar nga operatori ekonomik subjekti mbështetës operatori ekonomik “Ndërtimi 2014” SHPK, duke përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor që vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht 42,498,844, lëshuar nga autoriteti përkatës. Pra, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Ndërtimi 2014” SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm si dhe nuk përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Pasi vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që një operator ekonomik mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera me kusht që operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor. Referuar kufizimit të bërë nga ligjvënësi rezulton se operatori ekonomik “Malvin” SHPK 50 % të kapacitetit të xhiros e plotëson vetë si pjesëmarrës ndërkohë që për pjesën tjetër është mbështetur sipas parashikimeve të nenit 90 tek kapaciteti i subjektit mbështetës “Ndërtuesi 2014” SHPK. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori

ekonomik “Malvin” SHPK është në kushtet e përmbushjes së kriterit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit objekt ankimi.

Gjithashtu lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor se “shoqëria “Ndërtuesi 2014”, e cila ka dorëzuar vetëdeklarimin dhe vërtetimin për xhiron e tre viteve të fundit, por pa bilancet e kërkuara dhe aktin e ekspertizës. Kjo është një shkelje e kërkesave të tenderit për dokumentacionin financiar për subjektet ofertuese, duke rezultuar në mosplotësimin e kërkesës financiare”, pikë së pari Komisioni sqaron se në dokumentat standarte të tenderit për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi autoriteti kontraktor ka parashikuar në kriterin 2.2.2 se operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2021-2022-2023 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes “Malvin” SHPK konstatohet se ky i fundit në formularin përmbledhës të vetdeklarimit në Pjesën I: “Informacion në lidhje me operatorin ekonomik”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet operatori ekonomik (nëse është e zbatueshme) operatori ekonomik “Malvin” SHPK ka deklaruar në këtë deklaratë subjektin mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet konkretisht operatori ekonomik “Malvin” SHPK do të mbështetet mbi kapacitetin e operatorit ekonomik “Ndërtuesi 2014” SHPK për kapacitetin ekonomik-financiar pikën 2.2.1 në lidhje me xhiron vjetore për vitet financiare 2021-2022-2023” pra nga sa më sipër rezulton se operatori ekonomik ankimes ka deklaruar se mbështetet në kapacitetet e operatorit ekonomik “Ndërtuesi 2014” SHPK për kriterin 2.2.1 përse i përketë xhiron vjetore për vitet 2021, 2022, 2023, dhe jo sikurse pretendon autoriteti kontraktor për pasqyrat financiare kërkesë kjo e parashikuar si kriter më vetë konkretisht në pikën 2.2.2. Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ankimes “Malvin” SHPK ka paraqitur dokumentacionin “shkresë nr. 4123/1 prot., datë 06.12.2024 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër me objekt “Kthim përgjigje ” dhe përmbajtje: “Në përgjigje të kërkësës suaj, tonës me nr. 4123 prot, datë 06.12.2024, bashkalidhur po ju dërgojmë kopje të njësuara me origjinalin të deklaruar online në sistemin tatimor cats, si mëposhtëshënuar të”, - Pasqyrave financiare të vitit 2021, 20 (njëzetë) fletë;; - Pasqyrave financiare të vitit 2022, 22 (njëzetë e dy) fletë;; - Pasqyrave financiare të vitit 2023, 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë”. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e ekonomike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në këtë kuadër nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik “Malvin” SHPK ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Pasqyrat financiare për vitin ushtrimor (2021, 2022, 2023) me shkresën nr. 4123/1 prot., datë 06.12.2024 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër me lëndë “Kthim përgjigje”, drejtuar subjektit “Malvin” SHPK me përmbajtje si vijon “Në përgjigje të kërkësës suaj, tonës me nr. 4123 prot, datë 06.12.2024, bashkalidhur po ju dërgojmë kopje të njësuara me origjinalin të deklaruar online në sistemin tatimor cats”. Referuar kërkesës së autoritetit kontraktor, kriterit 2.2.2 të kriterëve të veçanat të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe

financiar, si dhe skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Malvin” SHPK me arsyen se “[...] shoqëria “Ndërtuesi 2014”, e cila ka dorëzuar vetëdeklarimin dhe vërtetimin për xhiron e tre viteve të fundit, por pa bilancet e kërkuara dhe aktin e ekspertizës. Kjo është një shkelje e kërkesave të tenderit për dokumentacionin financiar për subjektet ofertuese, duke rezultuar në mosplotësimin e kërkesës financiare”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me dokumentacionin e dorëzuar operatori ekonomik ankimues e plotëson kriterin 2.2.2 në lidhje me dorëzimin e bilanceve për vitet 2021, 2022 dhe 2023, dhe subjekti mbështetës nuk ka patur detyrim ligjorë për të dorëzuar edhe ai bilancet pasi sikurse në formularin përmbledhës të vetdeklarimit të operatorit ekonomik ankimues “Malvin” SHPK ashtu edhe në deklaratën e angazhimit të lëshuar nga subjekti mbështetës “Ndërtuesi 2014” palët kanë shprehur vullnetin e tyre për tu mbështetur në kriterin 2.2.1 përsa i përjetë xhiros vjetore dhe jo bilancet sikurse pretendon autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Malvin” SHPK, qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Malvin” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me pretendimin se: “Subjekti “Malvin” nuk plotëson kërkesën për të disponuar një punonjës me certifikatë “Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë”. o Ata kanë paraqitur një certifikatë për një punonjës, z. S. H., të pajisur me certifikatë me Nr. AQS/T/S134112024 të lëshuar nga shoqëria “AQScert” me NUIS L31511026K. Nga verifikimit i kryer në faqen zyrtare ë.qkb.gov.al në seksionin “Kerko për Subjekt”, “Shiko licensat aktive”, Shoqëria “AQScert” me NUIS L31511026K rezulton se nuk është e licencuar për ofrimin e formimit profesional, sipas ligjit nr. 15/2017, dhe nuk ka asnjë licencë aktive në regjistrin kombëtar të licencave. Kjo do të thotë që certifikata e lëshuar nga një subjektet e palicensuar nuk mund të merret parasysh, dhe kërkesa për këtë certifikatë nuk është përmbushur. Kete qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin Nr. 441/2020 dhe Nr. 745/2022 në lidhje me deshmite e lëshuara nga subjektet e palicencuara. 3. Mungesa e certifikatës për personelin e kualifikuar (Kriteri 2.3.7): Operatori ekonomik “Malvin” sh.p.k. me NUIS J76403034Q, nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3.7 të “Kapaciteti Teknik” ku kerkohet paraqitja e diplomes së shkolles, deshmi nga organe/institute të akredituara që të vërtetojë kualifikimin profesional të punonjesve, sipas ligjit Nr. 15/2027 “Per arsimin dhe formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”. Per kete kërkohej plotësimi i formularit sipas shtojcës 10 të DT-se si dhe me plotësimin e deklaratës sipas Tabeles 1. Operatori “MALVIN” sh.p.k. me deklarate “Lista E Punonjesve Specialiste të Shoqërisë Malvin” ka deklaruar punonjesit me iniciale A.H, A.H, S. D, N.H, A.A, Sh.K, A.H, me profesion “Punëtor Kopshtarie” ku janë të pajisur me diplome me certifikate të lëshuar nga shoqëria “AQScert” me NUIS L31511026K. Nga verifikimit i kryer në faqen zyrtare ë.qkb.gov.al në seksionin “Kerko për Subjekt”, “Shiko licensat aktive”, Shoqëria “AQScert” me NUIS L31511026K rezulton se nuk është e licencuar për ofrimin e formimit profesional, sipas ligjit nr. 15/2017, dhe nuk ka asnjë licencë aktive në regjistrin kombëtar të licencave”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.6 dhe 2.3.7 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar kriteri si më poshtë vijon:

2.3.6 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si: 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për te paktën 3 (tre) muajt të fundit

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili nga Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" sipas zerave të shërbimeve që marrin persiper në realizim të kontratës sipas aktmarreshjes). Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për te paktën 3 (tre) muajt e fundit, si më poshtë:

6 (gjashtë) punonjës të trajnuar për “Punime në kopshtari”

1 (një) shofer

1 (një) manovrator

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
- diplomën e shkolles/deshmi nga organe/institute të akredituar që të vërtetojë kualifikimin profesional të punonjesve të mësipërm sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën Shqipërisë.
- Listëpagesat për të paktën 3(tre)muajt e fundit

Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin që disponon sa më sipër sipas formatit të mëposhtem:

Tab 1

Emer Mbiemer i punonjesit dhe nr identifikimi	Profesioni	Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Nr NIPT (Në rast se leshuesi është institucion privat)
---	------------	--	--

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT si dhe me plotësimin e formatit të deklaratës sipas Tab 1.

Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

III.3.2. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 1/a në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;

III.3.3. Në përmbushje të kriterit të më sipër cituar, operatori ekonomik “Malvin” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

1- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Malvin” SHPK. Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate” operatori ekonomik “Malvin” SHPK deklaroi:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [<input checked="" type="checkbox"/>] Jo [<input type="checkbox"/>] Nëse, po, numri i punonjësve: 35 PUNETOR AKTUAL Profili i punonjësve 1., Inxhinier Pyjesh, njekohesisht Përgjegjes per Sigurine dhe 1., Inxhinierit ne Pune 3., Agronom 4., Manovrator 5., Punetor Kopshtarie 6., Punetor Kopshtarie 7., Punetor Kopshtarie 8., Punetor Kopshtarie 9., Punetor Kopshtarie 10., Punetore Kopshtarie 11., Punetor Kopshtarie 12., Shofer 13. Punetor te tjere sipas listepageses disponibel per tu angazhuar ne pronesi te nevojshme pune per kete kontrate
	Makineri e mjete Po [<input checked="" type="checkbox"/>] Jo [<input type="checkbox"/>] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: 1. me gjerësi mbi 80 cm, ne pronesi me fature tatimore date (.....) 2. me rrota 3 cope, ne pronesi me fature date 2 si dhe fature date 1

[Signature]
54-PT
103034

	3.l), ne pronesi me fature date 4.l h cope 1, ne pronesi me fature date 0 5.l e te ulet 2 cope, ne pronesi me fature ate : dhe fature date 6.l ne pronesi me fature date 1 dhe me fatura te tjera gjendje inventari 7. Depo ujie ne pronesi me fatre tatimore date 8.l ndryshme ne pronesi 20 cope, me fature tatimore date 1 fature tatimore date 9. cope 2, ne pronesi me fature tatimore date dhe fature tatimore date 1 10.l te larta cope 2, ne pronesi me fature tatimore date dhe me fatura te tjera gjendje inventari 11.l per materiale dhe punetor ne pronesi 1.5 ton, me targa 12.l sponda te larta, me qera nga sipas kontrates se qerese noteriale date 1 me afat 3 vjecar, me targa 13.l per karsitje ne lartesi, ne pronesi me targa
Emri, Mbiemri !	

2- Deklaratë mbi Profesionet.

"LISTA E PUNONJESVE SPECIALIST TE SHOQERISE MALVIN"

Nr	Emri, Mbiemri dhe ID	Profesioni	Institucioni Certifikues	Nipti I Institucionit certifikues
1	S.....	Inxhinier Pyjesh	Instituti I Larte Bujqesor	0
2	Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune	AQS CERT	L 31511026 K
3	Agronom	Instituti I Larte Bujqesor	0
4	Punetor Kopshtarie	AQS CERT	L 31511026 K
5	Punetor Kopshtarie	AQS CERT	L 31511026 K
6	Punetor Kopshtarie	AQS CERT	L 31511026 K
7	Punetor Kopshtarie	AQS CERT	L 31511026 K
8	Punetor Kopshtarie	AQS CERT	L 31511026 K
9	S.....	Punetor Kopshtarie	AQS CERT	L 31511026 K
10	J.....	Punetor Kopshtarie	AQS CERT	L 31511026 K
11	Manovrator	Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor	0
12	Shofer	Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor	0

Per subjektin "MALVIN" sh.p.k.
Administrator

III.3.4. Në nenin 2 "Qëllimi i ligjit" të ligjit nr. 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit

publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.6. Në nenin 77, pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.7. Neni 41 “Kërkesa të vecanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë...

III.3.8. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.3.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. **Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*

a) *operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

b) *operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

c) *personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

ç) *operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

d) *operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

dh) *operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve¹ të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

e) *operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

ë) *operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

f) *operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

g) *operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

gj) *operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) *operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.3.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë

reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.6 dhe 2.3.7 kapaciteti teknik të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si më sipër cituar, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokument të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, *në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar*, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim, mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues me dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, konkretisht ka deklaruar numrin e punonjësve që disponon, si dhe profilet e parashikuara në pikën 2.3.6 dhe 2.3.7 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, të dokumenteve të tenderit, gjithashtu ka dorëzuar edhe një deklaratë mbi profesionet, pra listë të punonjësve me profesionet përkatëse me të dhënat edhe të kompanisë certifikuese e cila ka lëshuar dokumentat certifikata për punonjësit.

III.3.11. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) nga operatori ekonomik “Malvin” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.6 dhe 2.3.7 të dokumenteve standarde të tenderit, operatori ekonomik ankimues, “Malvin” SHPK ka paraqitur “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” dhe “Deklaratë” mbi listën e punonjësve. Në dokumentin “Deklaratë” mbi listën e punonjësve, operatori ekonomik “Malvin” SHPK, ka deklaruar që stafi është i certifikuar nga subjekti privat me emrin tregtar “AQS CERT” Shpk me Nipt L31511026K. Duke iu referuar arsyes së skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor për operatorin ekonomik “Malvin” SHPK, sipas së cilës subjekti “AQS CERT”, me Nipt L31511026K, nuk është i licensuar për ofrimin e kurseve të formimit profesional për

(Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë dhe Punëtor Kopshtarie) dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, që të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

Komisioni i Prokurimit Publik ndodhet përballë nevojës për të kryer verifikime të mëtejshme në lidhje me arsyen e skualifikimit të autoritetit kontraktor. Referuar parashikimit në nenin 82, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht se: “Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”, pasi verifikoi në faqen zyrtare të qkb.gov.al në seksionin kërko në Rregjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në hapsirën Licencat, Lejet e lëshuara nga QKB, rezulton se subjekti AQS CERT me nipt L31511026K, nuk është i licencuar nga Ministria e Financave për të ushtruar aktivitetin për formim profesional dhe pajisjen e me certifikata trajnimi punonjës për profilet (Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë dhe Punëtor Kopshtarie).

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues dhe arsyes së skualifikimit nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku pretendon se subjekti “AQS CERT”, me Nipt L31511026K, nuk ofron kurse të formimit profesional për (Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë dhe Punëtor Kopshtarie) dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, që të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, Komisioni, pasi bëri verifikimet në faqen zyrtare të qkb.gov.al për subjektin privat AQS CERT, konstaton se, në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se punonjësit e deklaruar si të certifikuar nga subjekti “AQS CERT”, nuk janë të vlefshme dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor pasi subjekti “AQS CERT” nuk ofron kurse të formimit profesional për (Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë dhe Punëtor Kopshtarie). Për rrjedhojë operatori ekonomik ankimues “Malvin” Shpk nuk e përmbush kërkesën për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, për (Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë dhe Punëtor Kopshtarie), të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private), të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Për sa më sipër argumentuar, në procedurën e prokurimit, operatori ekonomik ankimues “Malvin” Shpk nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor ndaj dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Malvin” Shpk nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Malvin” SHPK, për operatorin ekonomik “Albgarden” shpk Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, referuar gjykimit mësipër në pikën

III.3, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Malvin” sh.p.k edhe pas ankimimit do të vijojë të ngelet i skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimuesin.

III.4.1. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (*argumentojë*), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (*qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit*), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (*legjitimimi locus standi*), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t’u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar.

III.4.2. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin, vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*), nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Malvin” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-30047-11-19-2024, me objekt: “*Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra dhe ujore*”, me fond limit 106,247,112 (njëqind e gjashtë milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë pa tvsh ose 1,082,276.7 (një milion e tetëdhjetë e dymijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) Euro. Kursi i këmbimit 98.17 Lekë/Euro, kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 18.11.2024 është 98.17 Lekë/Euro, zhvilluar më datë 20.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Malvin” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-30047-11-19-2024, me objekt: “*Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra dhe ujore*”, me fond limit 106,247,112 (njëqind e gjashtë milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë pa tvsh ose 1,082,276.7 (një milion e tetëdhjetë e dymijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) Euro. Kursi i këmbimit 98.17 Lekë/Euro, kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 18.11.2024 është 98.17 Lekë/Euro, zhvilluar më datë 20.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
 3. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimes sipas përcaktimeve në këtë vendim.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Malvin” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

